

PROGRAMI I CIKLIT TË II NGA E DREJTA EUROPIANE (LLM)

Fakulteti i Drejtësisë do të ofrojë program studimi nga cikli i dytë i studimeve nga ku meret diploma Magjistër në Drejtën Europiane (LLM).

I. PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I TË DIPLOMUARËVE NGA KY PROGRAM

Programi i ciklit të II nga e Drejta Europiane do të sigurojë njohuri solide dhe kuptim sistematikë të strukturës institucionale, procedurat kyçe të drejtësisë dhe kontekstet specifike të Drejtës Europiane. Vëmendje e veçantë do ti përkushtohet qasjes komparative me qëllim të identifikimit të praktikave të shteteve anëtare lidhur me implementimin e Drejtës së Unionit Europian. Programi gjithashtu do të sigurojë kualifikim post-diplomik për ata të cilët planifikojnë të luajnë rol kryesorë në lëminë e Drejtës Europiane dhe zgjerimit të UE në Ballkan dhe zgjerim të shkathtësive komunikative të cilat kanë vlerë të përgjithshme për ata të cilët kërkojnë arsimim post-diplomik. Programi do t'ju sigurojë studentëve shkathtësitë e duhura për ballafaqim me çështjet juridike të cilat lidhen me qasjen e Europës JL në Europë dhe inkurajonë studentët të zhvillojnë vetëdije kritike të operimit të Drejtës Europiane. Kërkesë e programit është që studentët të bëjnë hulumtime nën mbikqyrje për një temë të së Drejtës Europiane dhe inkurajojnë komentet origjinale dhe vlerësuse të cilët i përmbushin standardet e larta për bursa dhe ndihmonë studentët të zhvillojnë shkathtësi kritike, analitike dhe zgjidhje të problemeve të cilat mund të vëhen në përdorim në një spektër të gjërë të kontekstit ligjor dhe jo ligjor. Programi është dizajnuar të zhvillojë aftësi hulumtuese akademike nga lëmi i drejtësisë, veçanarisht me prezantimin e shkruar të argumenteve në atë mënyrë që përmbushen konventat relative akademike dhe të ndihmojë ata studentë që kanë për qëllim të vazhdojnë me hulumtimet akademike në një nivel më të lartë që do të marrin njohuritë e duhura për teknikat themelore duke ndjekur module të specializuara në metodat hulumtuese. Përfundimisht, programi do ti ndihmojë ato studentë që kanë për qëllim të vazhdojnë me karrierën në lëminë e integritit europian.

II. REZULTATET E MËSIMIT

Deri në fund të programit, studentët do të kenë njohuri dhe kuptim për: Institucionet e Unionit Europian dhe marrëdhëniet reciproke mes këtyre; ligji i cili është relevant për lëmitë kyçe të së Drejtës Europiane; perspektivat teorike dhe debatet akademike të cilët theksojnë lëmitë e rëndësishme të ligjit; metodologjia e së Drejtës krahasuese europiane; konceptet kryesore, çështjet politike, principet që lidhen me kodifikimin e Drejtës Europiane me shtetet anëtare dhe shtetet aspiruese.

Të diplomuarit do të jenë në gjendje që në mënyrë efektive të aplikojnë njohuritë efektive të së Drejtës Europiane në situata të ndryshme ku përfshihen praktikat relevante dhe pyetjet teorike. Ato gjithashtu do të jenë në gjendje të identifikojnë

përvojën e mirë nga shtetet anëtare të UE dhe zgjidhje të çështjeve lidhur me pranimin e shteteve të Europës JL në UE. Ata do të jenë në gjendje të vlerësojnë çështjet dhe të gjenë zgjidhje për çështjet që janë të lidhura me implementimin e së Drejtës së UE së bashku në Shtetet anëtare dhe shtetet aspiruese, për të formuluar argumente për çështjet qëndrore dhe lëmitë kontraverse dhe të prezantojnë mendime të arsyeshme bazuar në materiale relevante. Ata do të jenë në gjendje të njohin argumentet alternative potenciale dhe dëshmitë e kundërta, në bazë të mendimit të tyre dhe të prezantojnë justifikim të arsyeshëm. Ato gjithashtu do të jenë në gjendje të demonstrojnë pavarësi të mendimit dhe të ofrojnë sfidë kritike për njohuritë e mara në pyetjet e veçanta. Përfundimshist, ato do të jenë në gjendje që në mënyrë konstruktive të reflektojnë përparimin e tyre në mësim.

Mësimdhënia dhe studimi. Primare, shkathtësitë intelektuale të përmendura janë zhvilluar nëpërmjet përgatitjes dhe pjesëmarrjes në seminare. Kjo ofron shansin për interpretime të ndryshme të ligjit dhe politikës që në mënyrë kritike dhe të vëmendëshme të rishikohen, pozicionet alternative në mënyrë krahasuese të vlerësohen. Prezantimi i seminarëve mundet në mënyrë të dobishme të drejtohet kah ato fusha të cilat lejojnë një sferë diskutimesh debate, dhe informata kthyesë përkatëse. Shtesë, moduli i vlerësimit lejon dhe inkurajon, diskutime vlerësuese dhe prezantim të njëdiskutimi të tillë në pajtueshmëri me diskutimet e shkrimit akademik.

Ligjërata dhe seminare. Zakonisht, modulet ligjërohen në sesione dy orëshe të cilat zhvillohen brenda javës dhe përfshinë kombinim të ligjeratave dhe mësimdhënies seminarike. Gjërësisht, ligjeratat sigurojnë mundësi që ligjëruesit të përçojnë rëndësinë e kontekstit të përgjithshëm të lëndës, dhe një zgjerim të çështjeve kryesore dhe të identifikojë lëmi të diskutimit seminarik. Kjo njohuri konsolidohet me materialet e dhëna për lexim, veçanarisht për përgatitje të seminarëve. Seminarët fokusohen më shumë në diskutimet detajore të një lëmie të veçantë dhe zakonisht bazohen në punimet prezentuese të studentëve dhe prezantojnë diskutime për çështjet kritike. Për prezantim të punimit seminarik kërkohet nga studentët të formulojnë pikëpamjet e tyre për temën e cila përpunohet, dhe siguron informatë kthyesë nga stafi dhe studentët.

Vlerësimi i lëndës do të bëhet me kombinim të detyrave me shkrim (kollokfiume dhe provimi përfundimtar), të cilat përfshinë ese prej 4,000 deri 5,000 fjalë, të cilat duhet të dorëzohen për secilën lëndë pas kësaj pasojnë kollokfiume dhe provimet përfundimtare.

Në pjesën e fundit të programit kërkohet nga studenti të hulumtoj, shkruaj dhe dorëzoj disertacionin prej 15,000 deri 20,000 fjalë në lidhje me temën e caktuar nga e Drejta Europiane, nën mbikëqyrje të një anëtari të stafit me ekspertizë nga lëmia përcaktëse. Ushtrimi për hulumtim dhe përgatitje të disertacionit u siguron studentëve një nivel të lartë të shkathtësive hulumtuuese në gjetjen dhe përdorimin e materialeve të ndryshme. Angazhimet për mbikëqyrje ju mundësojnë informata kthyesë individuale për përparimin e punës së tyre.

Studentët janë të inkurajuar që në disertacionet e tyre të zhvillojnë shkathtësi relevante në një nivel më lartë, të sofistikuar dhe kjo paraqet një mundësi të rëndësishme për tu miratuar shkathtësi të ndryshme në ushtrimet me shkrim për prezantim.

III. PËRSHKRIM I PROGRAMIT DHE PLANIT MËSIMOR

Programi i magjistraturës në Drejtën Europiane do të ofrohet në studimet e rregullta dhe ato me korrespondencë. Studentët që ndjekin studimet e rregullta duhet të mbarojnë programin për një vit akademikë kurse ato me korrespondencë për dy vite. Studimet ndahen në ligjerata dhe punim të magjistraturës. Studentët e rregullt, gjatë dy semestrave duhet të ndjekin 8 lëndë dhe me atë që mbikëqyret punimi i magjistarurës, në temën relevante të caktuar, që duhet punuar gjatë pjesës tjetër të vitit akademik. Dy nga lëndët janë zgjedhore (nga një për secilin semestër) dhe duhet zgjedhur nga e Drejta ndërkombëtare ekonomike (shih përshkrimin e programit studimeve të ciklit të II nga e Drejta ndërkombëtare ekonomike nga meret diplomë magjistër i Drejtës Europiane). Studentët me korrespondencë, mësojnë nga tre lëndë për secilin vit akademik dhe punimin e magjistraturës e punojnë në pjesën e dytë të secilit vit akademik. Secili semestër i mbyllur me sukses ka 30 kredi dhe punimi i magjistraturës 30 kredi. Gjithësejt duhet 90 kredi për të marrë thirrjen magjistër i Drejtës Europiane.

Semester 1	<ul style="list-style-type: none"> • E drejta kushtetuse e UE (8 kredi) • E drejta ekonomike e UE (8 kredi) • E drejta e punësimit e UE (8 kredi) • Zgjedhore (2) (7 kredi gjithësejtë)
Semester 2	<ul style="list-style-type: none"> • E drejta e Mjedisit jetësorë (8 kredi) • E drejta konkurrencës në UE (8 kredi) • Mbrojtja gjyqësore në UE (7 kredi) • Zgjedhore (2) (7 kredi gjithësejtë)
Semester 3	<ul style="list-style-type: none"> • Tema klinike në koherencë të së Drejtës në Maqedoni me Drejtën Europiane (7 kredi) • Zgjedhore (2) (7 kredi gjithësejtë) • Hulumtime dhe punimi i disertacionit (16 kredi)

Lëndët zgjedhore

Zgjedhore (3 ose 4 kredi): dy vite

- E Drejta Private dhe Kontraktuese Europiane (4 kredi)
- E Drejta e Familjes Europiane (3 kredi)
- E Drejta Fiskale Europiane (4 kredi)
- Veprimi i jashtëm i UE (4 kredi)
- E Drejta Europiane e Migrimit (3 kredi)
- E Drejta Europiane e konsumuesit (harxhuesit) (4 kredi)
- E Drejta Shtetore Europiane për ndihmë (3 kredi)

IV. Kushtet e pranimit

Përveç kushteve të përgjithshme për regjistrim në programet e ciklit të dytë në UEJL, studentët e ardhshëm duhet t'i përmbushin këto kushte:

- 1) Diplomë universitare në Drejtësi dhe/ose punësim adekuatë ose përvojë praktike Ixhinjeri kompjuterike, Shkenca kompjuterike, Informatikë dhe Shkenca të komunikimit dhe teknologjitë (240 kredi)
- 2) Njohje të mirë të gjuhës angleze (TOEFL 600; IELTS 6.5, A në Cambridge Advanced Certificate in English)
- 3) Aprovim nga Komisioni për pranim (për studentët e diplomuar në disiplina të tjera mundë të kërkohet të nënshtrohen provimeve plotësuse të ciklit të I si pjesë e programit).

V. Instruktor:

Përshkrimi i lëndëve

Lëndët e obligative

E drejta kushtetuse e UE

Lënda mund të shihet si njohje me të drejtat themelore të së Drejtës së UE që u siguron studentëve mjetet themelore për të kuptuar principet dhe konceptet me të cilat do të punohet gjatë programit. Fokusohet në principet themelore ligjore të Drejtës kushtetuese të UE dhe institucionet. Liritë themelore (lëvizja e lirë e personave, të mirat dhe kapitalet) dhe drejta e qytetarëve të UE. Çështjet e lidhura direktë me zbatueshmërinë e drejtës së UE në shtetet anëtare gjithashtu analizohen në detaje. Theks i veçantë i jepet Kushtetutës së Re Europiane dhe sfidat që dalin nga procesi i ratifikimit kombëtarë dhe referendumi do të forcojë debatet rreth çështjeve kushtetuse të UE.

E Drejta Europiane Ekonomike dhe Ndërmarjes

Lënda është e ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përqëndrohet në thelbin e politikës së Unionit Europian duke analizuar në detaje principet e lëvizjes së lirë të mallrave, personave, shërbimeve për të siguruar një bashkpunim të afërt ekonomikë, monetar dhe union politikë. Duke u përqëndruar veçanarishtë në regjimet e lëvizjes së lirë të mallrave dhe shërbimeve, lënda studion interakcionin e këtyre sferave kyçe politike me çështjet tjera si që janë konkureca, ndihma sociale dhe të drejtat themelore. Referencat për një implementim të tillë të principeve në rregulloren ligjore të Maqedonisë.

Duke përdorur principet në lirinë e themelimit të kompanive shtetërore të formuara në Komunitetin pjesa e dytë e kursit thekson rregullat e komunitetit në formimin, hapjen, reprezentimin, pavalshmërinë, mbrojtjen e kapitalit, bashkimin, mbajtje llogarish dhe qeverisje të korporatës. Theks i veçantë u jepet mjeteve legale Europiane të dedikuara për të ndihmuar krijimin e menaxhmentit të kompanive me një dimension Europian, që do të thotë Grupimet Ekonomike Europiane dhe Shoqëria Europiane.

E drejta sociale e UE: e drejta europiane e punës dhe drejta europiane e sigurimit social

Kjo lëndë ka të bëjë me principet e UE lidhur me marrëdhëniet e punësimit. Pjesa e parë e lëndës veçanarisht fokusohet në të drejtat themelore të punëtorëve (rroga të barabarta, tretman të barabartë, zbatim të drejtave të barabarta, shtatwzania, pushimi i lindjes dhe arsyet familjare, shqetësim gjinor (sexual)), lëvizje e lirë e të punësuarëve dhe e drejta për vendosje. Ka të bëjë gjithashtu me të drejtat e punësimit në rikonstruimin e kompanisë në lidhje me transferin e marrveshjeve, tepricës kolektive dhe paaftësisë paguese. Pjesa e dytë ka të bëjë me aspektet e së drejtës të sigurimit social europian dhe pensionet si Rregullorja 1408/71 për Sigurim Social, Direktiva 79/7 për trajtim të barabartë në sigurimin social, Direktivat e UE dhe e drejta sipas praktikës për barazi dhe dalja në pension dhe pensionimi.

E drejta e mjedisit jetësor

Kjo siguron njohje me politikën dhe legjislacionin e UE në lidhje me mjedisin jetësor dhe mbrojtjen ekologjike. Një qasje për çështjet themelore duke përfshirë natyrën e Unionit, principet themelore të Unionit politikën dhe e drejtën e mjedisit, çështjet problematike siç janë tensionet në mes tregut të lirë dhe mbrojtjes së ambientit. Lënda përfshinë elemente të legjislaturës së pavarur të Unionit dhe drejtës sipas praktikës mbi kemikalet dhe mbeturinat, cilësia i ajrit dhe ujit, acidimi, natyra dhe burimet natyrore, ozoni dhe ndryshimi i klimës.

Mbrojta ligjore në Unionin Europian

Kjo lëndë ka të bëjë me zbatimin e të drejtave të garantuara me të drejtën e Unionit dhe mundësia për zgjidhje në gjyqjet shtetërore. Pas freskimit të pricipeve në zbatueshmërisë direkte të së drejtës së UE e analizuar në drejtën kushtetuese të UE , lënda fokusohet në të drejtën e partive private kur ata kërkojnë zbatojnë apo sfidojnë ligjet që dalin nga rregullat ligjore Europiane. Temat e më poshtme janë: partitë private dhe neni 230 i Marrveshjes së KE (dhe dispozitat relevante që i përmban Kushtetuta Europiane) veprimi për anulim, vlefshmëria në nenin 234 dhe dëmtimet në

nenin 288(2) i Marrëveshjes KE, rregulloret e procedurave përpara Tribunalit të Parë të Instancës dhe Gjyqi Europian i Drejtësisë. Lënda përfundon me krahasimin zgjidhjeve ligjore nën drejtën e UE me zgjidhjet e garantuara nga Konventa Europiane e Drejtave të Njeriut.

E drejta e konkurrencës në UE

Lënda u siguron pjesëmarrësve njohuri të mirëfilltë mbi të drejtën e konkurrencës në UE dhe evaluimin juridik të tij. Mbulon tiparet kryesore të nenit 81 dhe 82, të Marrëveshjes së UE (dhe dizpozitat relevante të përfshira në Kushtetutën e Europës) në të dy aspektet përmbajtësore dhe procedurale, duke përfshirë shkarkimet, qeveria nixt shtrebërimin konkurrencës, neni i 86 i marrëveshjes së UE, marrëdhëniet në mes UE dhe ligjit shtetëror të konkurrencës, kontrollë e përbashkët, dhe rregullorja mbi ndihmën e shtetit (nenet 87-89 të marrëveshjes së UE). Referenca për shtetet që do të implementojnë ose kanë implementuar principe të tilla në rregulloret shtetërore.

Tema klinike në koherencë të së Drejtës në Maqedoni me të Drejtën e UE

Republika e Maqedonisë është shteti i parë në rajon që ka nënshkruar Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asocim me Unionin Europian dhe Shtetet Anëtare, më 9 prill 2001, në Luksemburg. Lënda prezanton raste studimi lidhur me implementimin e aspekteve specifike të legjislacionit të UE dhe çështjet lidhur me harmonizimin e legjislacionit të Maqedonisë me atë të UE. Këto raste studimi do të zgjidhen nga Marrëveshja për Asocim dhe Stabilizim nga pjesa e Standardeve të drejtave të njeriut dhe principet e lëvizjes së lirë të mallërave midis Republikës së Maqedonisë dhe Unionit Europian, pagesat, konkurrenca dhe provizione tjera ekonomike.

Lëndët zgjedhore

E Drejta Private dhe Kontraktuese Europiane

Lënda ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë fokusohet në principet private ndërkombëtare, të cilët janë zhvilluar nga institucionet e UE, në formë të konventave, rregulloreve, direktivave dhe si vendime të gjyqit. Theksi vëhet në rregullat e juridiksionit, përforcimi dhe e drejta e zbatueshme me theks të veçantë në Konventën e Romës mbi të Drejtën e zbatueshme ndaj obligimeve të kontaktuesit, Konventa e Brukselit mbi Juridiksionin në Konventat Ndërkombëtare, tekst lidhur me këtë (Konventa e Luganos) dhe amendamentet pasuese. Pjesa dytë përqëndrohet në *Principet e së Drejtës Kontaktuese Europiane (Principles of European Contract Law (PECL))*, e përpiluar nga Komisioni për të Drejtën Kontraktuese Europiane, më mirë, i njohur Lando Komisioni, ngase principet rrjedhin nga një numër i traditave ligjore, një kuptim themelor i koncepteve të ndryshme kontraktuese që janë mes shteteve anëtare. Referohet edhe për *UNIDROIT Principet e Kontratave Ndërkombëtare Komerciale dhe Konventa e KB mbi Shitjen Ndërkombëtare të Mallërave (Konventae e Vjenës)*. Jepet një pamje e përgjithshme e vendimeve gjyqësore relevante që u përkasin elementeve legjistaltive të lartpërmendura.

E Drejta Europiane e Familjes

Lënda fokusohet në aspektet specifike të së Drejtës Familjare të Konventës Europiane për mbrotje të Drejtave të Njeriut dhe instrumentet legjislativë (dhe vendimet gjyqësore relevante), që rrjedhin nga legjislativa e UE, siç janë Rregullorja (UE), No. 1347/2000 nga 29 maji 2000, *Rregullorja Bruksel II* dhe (UE) No 2201/2003 e 27 nëntorit 2003, *Rregullorja e re Bruksel II*. Temat që shtjellohen në këtë lëndë janë: natyra e martesës (duke përfshirë, p.sh. poligaminë, ose martesë të njëjtës gjini) dhe mbrotja ligjore e bashkëjetesës; kushtet ndër të cilat shkëputja është e ndaluar; martesë dhe regjimi i pronës kur çiftet ndahen; regjimet e trashëgimisë; mirëmbajtja; krijimi i marrëdhënies ligjore prindër dhe fëmijë (rasti *Marckx*); pozita e veçantë e fëmijëve që nuk janë në martesë (diskriminimi, *inter alia*, trashëgimia); kujdestari dhe qasje të fëmijët kur prindërit janë të shkëputur; adoptimi dhe birësimi; përdorimi i ndihmës në teknikat e lindjes, e drejta e fëmijëve për të vazhduar si të pavarur të drejtë në çështjet familjare; e drejta e fëmijëve për të marrë vendime; e drejta e personit të dijë origjinën biologjike; mbrotja e fëmijëve, masat në perspektivën kushtetuese; koncepti i diskriminimit në të drejtën e familjes, adoptimi ndërshtetëror dhe rregullimi ligjor i grabitjes prindërore të fëmijëve. Më pas, vëmendje i kushtohet çështjes së harmonizimit të së drejtës familjare dhe mënyrës se si kjo mund të arrihet.

E Drejta Fiskale Europiane

Lënda ka të bëjë me implikimin e tatimeve të Integritimit Europian dhe politikën e harmonizimit të tatimit në Komunitet, rregullat tatimore të UE në fuqi dhe në pritje, si dhe vendimet Gjyqësore të UE lidhur me çështjet tatimore. Përmbatja mund të ndahet në gjashtë tema kryesore: konsekuencat e përgjithshme (jofiskale), E Drejta e Komunitetit për të drejtën shtetërore tatimore siç është treguar në vendimin e gjyqit të *Court of Justice* të UE (jodiskriminuese dhe jorestriktive dhe dallimi në mes tatimpaguesve rezidentë dhe jorezidentë dhe në mes burimeve të të ardhurave shtetërore dhe të huaja, ndihma shtetërore dhe nxitja e tatimeve, OECD Modeli i Marrëveshjes Tatimore (Model Tax Treaty) dhe Marrëveshjet e Lira të UE (EC Treaty Freedoms), Lojaliteti i Komunitetit (Community Loyalty), marrëveshjet tatimore me vendet e treta; politika e Komunitetit mbi harmonizimin e tatimeve (Letra e Bardhë (the White Paper), raporti Ruding (Ruding Report), harmonizimi tatimore indirekte, Monti Paper, paketa për të ndaluar konkurrencën e dëmshme të tatimeve; Kordinim të tatimeve; e drejta sekondare e komunitetit në fuqi dhe në pritje në lidhje me taksat indirekte (tatimi mbi vlerën e shtuar, kodi i taksave doganore të komunitetit, taksat indirekte, tatimi kryesor); e drejta sekondare e komunitetit në fuqi dhe në pritje lidhur me taksat direkte (direktiva e shtesës prindore, direktivat e bashkimit, Konventat e Arbitrimit; direktivat e propozuara në humbjen, interesi *intragroup* dhe pagesat mbretërore dhe tatimi efektiv në të hyrat e kursimeve); aspektet e tatimeve të *European Economic Interest Grouping* (EEIG) dhe Kompanitë Europiane (*Societas Europaea* : SE); ndihmesa administrative në mes administratës tatimore të shteteve të ndryshme anëtare.

Veprimi i jashtëm i UE

Lënda e analizon rolin e UE si pjesëmarrës global dhe filozofinë specifike të politikës së jashtme, e cila mund të definohet si “shumëpalësi efektive”. Theks i veçantë u jepet

çështjeve lidhur me zgjerimin e UE në Balkan. Shumëllojshmëria e instrumenteve legjislativë, që veçanërisht janë krijuar për t'u përgjigjur relacioneve me shtetet që nuk janë anëtare të UE analizohet në detaje (Marrëveshjet e asocimit (me theks të veçantë Marrëveshjes për Asocim me Republikën e Maqedonisë), marrëveshjet për përgatitje për praninë në UE, apo themelimi i Unionit Doganor, Marrëveshjet në Hapësirat Europiane Ekonomike (EEA), marrëveshjet ndërkombëtare). Aspektet tjera rreth veprimeve të jashtme do të përpunohen në pjesën e dytë të lëndës, në veçanti tregëtia e jashtme, politika humanitare dhe politika e zhvillimit. Instrumentet kontraktuese dhe ligjore (procedura e tenderëve dhe ligjeshlacionet relevante për gjetje dhe rregulloret), përkrahja për zhvillim, si dhe analizohet ndihma humanitare.

E drejta europiane e migrimit

Lënda fokusohet në aspektet e ligjit të migrimit dhe politikës. Pas analizimit të konceptit për shtetësi Europiane, rregullat e UE lidhur me lëvizjen e lirë të personave në relacion me shtetet që nuk janë anëtare dhe qytetarët e shteteve anëtare të reja të BE analizohen dhe diskutohen. Pjesa e fundit e lëndës, koncentrohet në politikën europiane të migrimit. Në këtë kontekst, pozita e shteteve të treta, refugjatët dhe azilkërkuesit, analizohet në detaje.

E drejta europiane e konsumatorit

Politika e konsumatorit është komponentë kryesore e strategjisë objektive të bashkësisë për të përmirësuar cilësinë e jetës së gjithë qytetarëve e përmendur në Marrëveshjen e BE. Lënda fokusohet në instrumentet kryesore legjislativë dhe vendimet gjyqësore relevante mbi të drejtën e konsumatorit (dhe vendimet relevante), të miratuara në vitet tetëdhjetë. Këto tema shtjellohen: siguria e konsumatorit, me theks të veçantë, mbi principet e detyrimit për prodhimet defektive; rregulloret mbi sigurinë e interesit të konsumatorit, me theks të veçantë, principet mbi termat jo të drejta kontraktuese dhe praktikat komerciale dhe reklamimet krahasuese ç'orientuese; E-biznisi, shitja nga distanca dhe në prag të derës, shitja e mallit garanton dhe rregulloret mbi vendimin gjyqësorë të BE.

E drejtat europiane mbi ndihmën shtetërore

Lënda mbulon normat dhe rregullativat lidhur me ndihmën shtetërore në BE dhe rolin e tyre në BE politikën gjithëpërfshirëse të konkurrencës. Studion dispozitat dhe ndrikimet e nenit 92 dhe 93 të Marrëveshjes të BE dhe mbulon të drejtën e pavarur dhe pyetjet procedurale. Këto tema mbulohen: E drejta e pavarur e ndihmës shtetërore (Neni. 92 Marrëveshja e BE), E drejta procedurale e ndihmës shtetërore (neni. 93 Marrëveshja e BE), Marrëveshja ECSC, Marrëveshja EEA, Marrëveshja për tregëti të lirë UE/Zvicra, Marrëveshja e UE/Shtetet e Europës Lindore dhe qendrore.